



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 250

Tiranë – E martë, 19 janar 2016

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1110, datë 9.12.2015	Për përcaktimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si organi i interesuar, dhe autorizimin e saj për të lidhur shtesë kontrate, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, me firmën avokatore “Wragge Lawrence Graham & Co LLP, për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar kundër Hydro S.R.L., Construzioni S.R.L., Francesco Becchetti, Mauro de Renzis, Stefania Grigolon dhe Liliana Condomitti.....	16993
Udhëzim i ministrit të Financave, nr. 33, datë 28.12.2015	Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2015.....	16993

**VENDIM****Nr. 1110, datë 9.12.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E MINISTRISË SË
ENERGJISË DHE INDUSTRIËS, SI
ORGANI I INTERESUAR, DHE
AUTORIZIMIN E SAJ PËR TË LIDHUR
SHITESË KONTRATE, NËPËRMJET
AVOKATURËS SË SHETIT, ME FIRMËN
AVOKATORE “WRAGGE LAWRENCE
GRAHAM & CO LLP”, PËR
PËRFAQËSIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË ÇËSHTJET E
ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR
KUNDËR HYDRO S.R.L.,
CONSTRUZIONI S.R.L., FRANCESCO
BECCHETTI, MAURO DE RENZIS,
STEFANIA GRIGOLON DHE LILIANA
CONDOMITTI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, 5, pika 1, shkronja “b”, 12, pikat 2 e 6, 15, pika 8, e 18, pika 2, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si organin e administratës publike të interesuar në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar kundër Hydro S.R.L., Construzioni S.R.L., Francesco Becchetti, Mauro de Renzis, Stefania Grigolon dhe Liliana Condomitti.

2. Autorizimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë që, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, të lidhë shtesë kontrate, me firmën avokatore “Wragge Lawrence Graham & Co LLP”, e cila është përzgjedhur nga Avokatura e Shtetit përmes një procedure konkurruese për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në dy çështje arbitrazhi ndërkombëtar, të inicuar nga persona fizikë ose juridikë, pjesëtarë të grupit Becchetti.

3. Shtesa e kontratës të rregullojë përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar kundër Hydro S.R.L., Construzioni S.R.L., Francesco Becchetti, Mauro de Renzis, Stefania Grigolon dhe Liliana Condomitti.

4. Shpenzimet për pagesën e firmës avokatore ndërkombëtare, në vlerën 1 950 000.00 (një milion

e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) euro, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Një pjesë e vlerës prej 750 000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) eurosh të përballohet, ashtu sikundër parashikohet në kontratën për ofrimin e shërbimeve ligjore, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, e përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, dhe firmës avokatore ndërkombëtare “Wragge Lawrence Graham & Co LLP”, nga buxheti i vitit 2015. Shuma e mbetur të përballohet nga buxheti i shtetit i viteve 2016 dhe i viteve të mëpasshme, në varësi të procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar, sipas rregullave të të cilit gjykohen mosmarrëveshjet me palë Republikën e Shqipërisë.

5. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM**Nr. 33, datë 28.12.2015**

**PËR PROCEDURAT E MBYLLJES SË
LLOGARIVE VJETORE TË BUXHETIT
PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 62 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe në vijim të pikës 260, të udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,

UDHËZOJ:

**I. Përmbajtja dhe publikimi i pasqyrës
financiare vjetore të konsoliduar të shpenzi-
meve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme.**

1. Për llogari të buxhetit të shtetit të vitit 2015, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen:

a) Të gjitha të ardhurat e arkëtuara, të regjistruara në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) nga data 1.1.2015 deri më



31.12.2015 (duke përfshirë datën 31.12.2015);

b) Të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 1.1.2015 deri më 31.12.2015, të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të regjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2015, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave.

2. Për llogari të buxhetit të shtetit 2015, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, në seksionin e financimit të deficitit fiskal, përfshihen të gjitha transaksionet e regjistruara në SIFQ, si më poshtë:

a) Të gjitha të ardhurat e arkëtuara nga shitja/privatizimi i aktiveve afatgjata publike gjatë vitit 2015;

b) Të gjitha arkëtimet e lidhura me huamarrjen e huaj deri në fund të datës 31.12.2015;

c) Arkëtimet neto që lidhen me borxhin e brendshëm;

d) Të gjitha ripagesat e borxhit të jashtëm, të kryera deri në datën 31.12.2015;

e) Ndryshimi i gjendjes së mjeteve monetare në të gjitha llogaritë e çelura nga ministri i Financave në Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë;

f) Gjendja e likuiditeteve në udhëtim që figurojnë si të tilla në fund të datës 31.12.2015.

3. Struktura përgjegjëse për thesarin në Ministrinë e Financave përgatit të dhënat faktike përfundimtare të pasqyrës vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme brenda datës 15.2.2016.

4. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme publikohet nga Ministria e Financave në muajin shkurt 2016.

5. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, e shoqëruar me raportin përfundimtar të gjendjes faktike të shpenzimeve dhe të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit 2015, i paraqitet Këshillit të Ministrave brenda muajit maj të vitit 2016.

II. Marrëdhëniet e Ministrisë së Financave me bankat e nivelit të dytë.

6. Në zbatim të marrëveshjes me Ministrinë e Financave, bankat e nivelit të dytë kryejnë arkëtime të fondeve publike për llogari të vitit 2015 deri në fund të ditës, më datë 31.12.2015. Bankat e nivelit të dytë transferojnë në Bankën e Shqipërisë, brenda orës 10:00, të datës 5.1.2016, të gjitha mjetet

monetare të arkëtuara për buxhetin e shtetit deri në fund të datës 31.12.2015. Llogaritë e degëve të thesarit në bankat e nivelit të dytë do të fillojnë me gjendje zero në vitin 2016.

7. Degët e thesarit përfundojnë rakordimin me bankat e nivelit të dytë dhe raportojnë elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin në Ministrinë e Financave, brenda datës 11.1.2016.

8. Sistemimet që nuk kanë ndikim në balancën e llogarisë unike të thesarit, do të kryhen në SIFQ nga vetë degët e thesarit dhe degët e bankave të nivelit të dytë, pa konfirmim nga struktura e Thesarit në qendër.

9. Përmbledhëset për sistemimet, të cilat kanë ndikim në balancën e llogarisë unike të thesarit, do të paraqiten elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin pranë Ministrisë së Financave deri në datën 14.1.2016 dhe do të kryhen nëpërmjet SIFQ me urdhër të ministrit të Financave. Informacioni elektronik do të shoqërohet me aktrakordimin e skanuar të mbajtur midis degës së thesarit dhe degës së bankës së nivelit të dytë.

10. Bankat e nivelit të dytë, para konfirmimit përfundimtar të rakordimit vjetor me strukturën përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë dhe me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë, duhet të sqarojnë më parë mosrakordimet e mundshme me subjektet që operojnë dhe mënyrën e sistemimit të tyre.

11. Drejtoritë qendrore të bankave të nivelit të dytë rakordojnë me strukturën përgjegjëse për thesarin në Ministrinë e Financave sipas formatit të dërguar nga kjo e fundit, brenda datës 18.1.2016.

III. Marrëdhëniet e Ministrisë së Financave me Bankën e Shqipërisë.

12. Ministria e Financave do të urdhërojë kryerjen e pagesave në Bankën e Shqipërisë deri në fund të sesionit të dytë të pagesave të datës 31.12.2015.

13. Llogaria “Depozita e qeverisë” dhe të gjitha llogaritë speciale të ministrit të Financave në Bankën e Shqipërisë, në datën 5.1.2016, do të mbartin tepricën e mbylljes së këtyre llogarive në datën 31.12.2015.

14. Procesi zyrtar i rakordimit me Bankën e Shqipërisë, për arkëtimet dhe pagesat e qeverisjes së përgjithshme të kryera për vitin 2015 fillon në datën 5.1.2016 dhe përfundon në datën 25.1.2016.

15. Struktura përgjegjëse për borxhin në Ministrinë e Financave përfundon regjistrimin në



SIFQ të transaksioneve të borxhit të brendshëm dhe borxhit të jashtëm brenda datës 15.1.2016.

16. Struktura përgjegjëse për thesarin në Ministrinë e Financave përgatit brenda datës 20.1.2016 raportin përfundimtar të hyrjeve dhe daljeve të llogarisë bankare “Depozitë e qeverisë”, për të cilën merr konfirmimin zyrtar nga Banka e Shqipërisë.

IV. Marrëdhëniet e Ministrisë së Financave me njësitë e qeverisjes së përgjithshme

17. Bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes së përgjithshme do të urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve në degët e thesarit deri në fund të ditës së punës, më 31.12.2015. Dega e Thesarit kryhen kontrollat sipas legjislacionit në fuqi lidhur me vlefshmërinë e fondeve dhe ekzistencën e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur dhe të marrë në dorëzim brenda datës 31.12.2015 (fatura e furnitorit duhet të jetë gjeneruar brenda dhjetorit 2015).

18. Në rastet kur institucioni provon shpenzimin e ndodhur gjatë muajit dhjetor 2015 (fatura sipas pikës 17) brenda kufirit të fondeve disponibël, por procedurat e marrjes në dorëzim të shërbimeve apo të punimeve të kryera zgjasin përtej datës 31.12.2015, atëherë dega e thesarit pranon njohjen dhe regjistrimin në SIFQ të shpenzimeve për llogari të vitit 2015. Regjistrimi i faturave duhet të përfundojë dhe të kryhet rakordimi përfundimtar me institucionin sipas afatit të caktuar në pikën 21 të këtij udhëzimi.

19. Për transfertat e fondeve buxhetore me formën e pagesës letër-kredi (LC) për kontrata të rëndësishme të veçantë (në zbatim të pikës 147, të udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” nga llogaria e unifikuar e Thesarit “Depozitë e qeverisë” në llogarinë bankare të veçantë të njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme në një nga bankat e nivelit të dytë, në treguesit fiskalë të konsoliduar të qeverisjes së përgjithshme përfshihet gjendja bankare, më 31.12.2015, në zërin “Të tjera” të burimeve të financimit të brendshëm të deficitit.

20. Degët e thesarit përfundojnë rakordimin me degët e tatimeve dhe doganave dhe raportojnë në strukturën përgjegjëse të thesarit pranë Ministrisë së Financave brenda datës 15.1.2016.

21. Njësitë e projekteve me financime të huaja, ISSH dhe FSDKSH, dorëzojnë raportin përfun-

dimtar të të ardhurave e shpenzimeve në strukturat përgjegjëse për borxhin dhe thesarin pranë Ministrisë së Financave, brenda datës 15.1.2016.

22. Brenda datës 25.1.2016, degët e thesarit rakordojnë me njësitë e qeverisjes së përgjithshme për shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2015. Gjatë procesit, degët e thesarit duhet të rakordojnë me njësitë e qeverisjes së përgjithshme për statusin e ekzekutimit të çdo kontrate, duke respektuar udhëzimin e operacioneve ditore në SIFQ.

Në rastet e konstatimeve të gabimeve të regjistrimeve në sistem të shkresave të ndryshimit të planit vjetor të buxhetit të shtetit të vitit 2015, degët e thesarit i raportojnë si të tilla në strukturën përgjegjëse për buxhetin dhe strukturën përgjegjëse për thesarin, të cilat bëjnë sistemimet përkatëse. Për çdo mospërputhje të këtyre planeve, në nivel programi, kapitulli, artikulli do të bëhen sistemimet me strukturën përgjegjëse për buxhetin, e cila përgatit aktrakordin paraprak elektronik me njësitë e qeverisjes qendrore për planin përfundimtar të vitit 2015 deri në datën 25.1.2016.

23. Përveç rakordimeve të bëra sipas pikës 21, degët e thesarit duhet që brenda datës 30.1.2016 të rakordojnë me të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për të cilat gjatë vitit 2015 janë çelur fonde për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, për pagesat e kryera gjatë vitit 2015 nga ana e tyre në nivel fature/vendimi gjyqësor. Ky rakordim do të realizohet duke u bazuar në informacionin mbi fondet e çelura për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2015, që do të dërgohet në degët e thesarit brenda datës 9.1.2016 nga Njësia e Posaçme e Administrimit dhe Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura në Ministrinë e Financave.

24. Degët e Thesarit për arkëtimet e vitit 2015, në favor të njërive të qeverisjes së përgjithshme (fonde të cilat në zbatim të legjislacionit përdoren nga njësia e qeverisjes së përgjithshme dhe trashëgohen në vitin 2016), mbartin tepicën e fondeve të papërdorura të të ardhurave të vitit 2015, në strukturat buxhetore përkatëse pas përfundimit të rakordimit të degës së thesarit me njësinë respektive të qeverisjes së përgjithshme.

25. Fondet e investimeve, të akorduara për Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) në programin me kod 04590 “Mbështetje për infrastrukturën urbane dhe rurale”, për infrastruk-



turën vendore, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, që rezultojnë të papërdorura në fund të vitit 2015, do të mbartin në vitin e ardhshëm në të njëjtën strukturë buxhetore, pas rakordimeve përkatëse të degës së thesarit me FSHZH-në.

26. Fondet e investimeve, të akorduara për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, me vendime të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, shtylla II, programi “Shqipëria dixhitale”, që rezultojnë të papërdorura në fund të vitit 2015, do të mbarten në vitin e ardhshëm në të njëjtën strukturë buxhetore, pas rakordimeve përkatëse të degës së thesarit.

27. Struktura përgjegjëse për thesarin në Ministrinë e Financave publikon të dhënat faktike të detajuara në nivel njësie shpenzuese sipas strukturës buxhetore, në faqen elektronike zyrtare të Ministrisë së Financave brenda datës 1.2.2016.

28. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, rakordon me njësitë e qeverisjes qendrore, planin e buxhetit të shtetit të vitit 2015 në nivel grupi, programi, kapitulli e artikulli, përfshirë edhe limitin e përdorimit të të ardhurave të institucioneve buxhetore. Gjithashtu, njësitë e qeverisjes qendrore, duhet të raportojnë shumën e shpenzimeve të realizuara nga të ardhurat jashtë limitit. Për të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, për të cilat gjatë vitit 2015 ndryshuan fushat e mbulimit dhe përgjegjësitë në zbatim të VKM-ve përkatëse, gjë që u reflektua edhe në ndryshimin e programeve buxhetore në aktin normativ nr. 1, datë 29.1.2015, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, rakordimi i planit të buxhetit për vitin 2015 me Ministrinë e Financave do të bëhet me ministritë dhe institucionet aktuale, si edhe me kundër firmën e ministrit apo institucionit që ka administruar më parë këto programe. Procesi i rakordimit përfundon në datën 30.1.2016.

29. Në raportet e monitorimit, për vitin 2015, për programet që kanë ndryshuar sipas aktit normativ nr. 1, datë 29.1.2015, monitorimi me të gjithë treguesit vjetorë do të paraqitet nga ministritë dhe institucionet aktuale.

30. Procesi i regjistrimit në SIFQ dhe rakordimit me kreditorët për financimet e huaja midis strukturave përgjegjëse të thesarit, borxhit dhe njërive të qeverisjes së përgjithshme duhet të përfundojë brenda datës 12.2.2016.

31. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të raportojnë brenda datës 31.12.2015, fondet e papërdorura në vitin 2015, të detajuara sipas burimeve të financimit, si më poshtë:

a) nga granti i qeverisjes qendrore, në kapitullin 1 “Çelje nga buxheti”;

b) nga të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së tyre, në kapitullin 5 “Të ardhurat e veta”;

c) nga të ardhurat e krijuara në zbatim të legjislacionit specifik, në kapitullin 6 “Të ardhurat jashtë limitit”.

V. Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes së përgjithshme.

32. Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimi i pasqyrave financiare do të vazhdojë të kryhet në bazë të udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007, “për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, vendore dhe njësitë që varen prej tyre, si dhe të njërive të zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 27.2.2008.

33. Degët e thesarit gjenerojnë nga sistemi SIFQ brenda datës 1.2.2016 informacionin financiar disponibël/pasqyra financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë të dhënat përfundimtare, të cilat i pasqyrojnë në SIFQ (periudhën e 13-të) nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë, në zbatim të manualeve përkatëse.

34. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme me vetëfinancim, hartojnë pasqyrat financiare vjetore sipas formatit të miratuar nga ministri i Financave (pika 31 e këtij udhëzimi) dhe i paraqesin, jo më vonë se data 30.3.2016, në strukturën përgjegjëse për thesarin në Ministrinë e Financave dhe në strukturën përgjegjëse për statistikën pranë INSTAT-it.

VI. Masa administrative

35. Procesi i rakordimit përfundimtar të të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme, si dhe mbyllja e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit, monitorohet nga nëpunësi i parë autorizues nëpërmjet strukturës përgjegjëse për thesarin.



36. Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi, nga ana e punonjësve të Ministrisë së Financave, të përfshirë në proces, do të aplikohen masa administrative sipas shkallës së shkeljes së provuar.

37. Do të aplikohen gjoba nga 1-3 rroga mujore deri në largim nga puna mbi të gjithë specialistët e degëve të Thesarit që regjistrojnë fatura me datë përpara datës së paraqitjes së tyre në Thesar, apo pa respektuar radhën kronologjike të paraqitjes së faturave nga institucionet në thesar, pasi shkaktojnë artificialisht krijimin e detyrimeve të prapambetura në sistem.

38. Procedura e ndjekur dhe shpenzimet e regjistruara në SIFQ nga punonjësi i degës së thesarit sipas pikës 17 të këtij udhëzimi, do të jetë objekt monitorimi nga nëpunësi i parë autorizues i Ministrisë së Financave. Për shkeljet e konstatuara merret masë administrative deri në largim nga puna të punonjësit të thesarit.

39. Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi, nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive të qeverisjes së përgjithshme, nëpunësi i parë autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

40. Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga bankat e nivelit të dytë, ministri i

Financave aplikon penalitetet e parashikuara në marrëveshjen me bankat.

41. Për të gjitha kthimet e pagesave elektronike, që janë për shkak të:

a) Udhëzimeve të gabuara për plotësimin e dokumentacionit të paraqitur në Thesar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pagesa e komisionit bankar do të bëhet nga fondet operative të këtyre të fundit, me iniciativë të strukturës përgjegjëse për thesarin në Ministrinë e Financave, në bazë të procesverbalit të mbajtur midis njësisë shpenzuese dhe degës së thesarit;

b) Regjistrimit të gabuar nga specialisti i degës së thesarit, atëherë pagesa e komisionit do të mbahet nga paga e specialistit;

c) Gabimeve nga banka e nivelit të dytë, atëherë nuk do të paguhet komision, por me bankën përkatëse do të mbahet procesverbal për mosrespektimin e kushteve të marrëveshjes.

Për të gjitha rastet e udhëzimeve të gabuara, banka e nivelit të dytë bën kthimin menjëherë të pagesës së gabuar në Llogarinë Unike të Thesarit, për t’u proceduar me korrigjimin nga degët e thesarit në bashkëpunim me njësinë shpenzuese.

42. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë